

* **Klassencockpit – Informatë prindore**

Klassencockpit është një sistem modul me përmbledhje detyrash për lëmitë profesionale Gjermanisht dhe Matematik. Vlerësimi i rezultateve vijon përmes Online-Datenbank (sistem elektronik i të dhënave).

Klassencockpit do të përdoret nga arsimtarët si mjet ndihmës për përcaktimin e pozitës.

Klassencockpit mundëson krahasimin e kapacitetit me klasat tjera në lëmitë profesionale Gjermanisht dhe Matematik.

Klassencockpit-Modulet orientojnë në arritjen e qëllimeve të caktuara të mësimit.

Klassencockpit-Modulet do të zbatohen sikurse aktivitetet (punët) tjera të klasës gjatë mësimit.

Klassencockpit-Modulet mund të përdoren tre herë në vit, prej klasës 3-të deri në të 9-tën.

Rezultatet e më shumë moduleve të *Klassencockpit* mundësojnë arsimtarëve një vlerësim të aftësive (kapacitetit) të nxënësve dhe nxënësëve tuaj.

Klassencockpit-Modulet mbeten në dorë të arsimtarëve dhe mund të shihen në një mbledhje prindore.

Për informata më të hollësishme në www.klassencockpit.ch

* Klassen – Klasë e shkollës

* Cockpit – Vend i pilotit në aeroplan